

Hapi 1: Zgjidhni midis 2 Starter Seteve:

STARTER SET BASIC

8,500 Lekë Kodi 95452-134

Starter Set Basic përmban Welcome Kit të cilin e përfitonin dhuratë

+ **Produkte sipas zgjedhjes tuaj me vlerë 8,500 Lekë**

PW dhe GW e Starter Set-it janë sa produktet që ndodhen në të.

Welcome Kit përmban:

- 1 Collection
- 1 Listë çmimesh Collection
- 1 LR WORLD

Në porosinë e parë që do të bëni në muajin e parë pas regjistrimit do të përdorni kuponin dhuratë **1,240 Lekë**. Për të përdorur kuponin duhet të bëni një porosi me vlerë minimale **5,000 Lekë** dhe duhet të specifikoni që dëshironi të përdorni kuponin dhuratë në momentin e kryerjes së porosisë.

1,240 Lekë
KUPON LR

DHURATË



STARTER SET BUSINESS

16,000 Lekë Kodi 95453-234

Starter Set Business përmban Welcome Kit me vlerë nga **10,320 Lekë** në **4,400 Lekë**
+ **100 PW:**

- Welcome kit përmban:**
- 3 Kontratë Bashkëpunimi
 - 1 Collection
 - 1 Listë çmimesh
 - 3 LR World
 - 1 Lista e emrave
 - 1 Pasaporta e Karrierës
 - 1 Broshurë "Prezantimi i Kompanisë"
 - 1 LR Marketing Plan
 - 1 Broshurë Starbox
 - 1 Dosje Mirëseardhjeje
 - 10 LR Lifetakt Flyer
 - 1 Broshurë Boddy Mission
 - 10 Zeitgard Flyer
 - 10 Aloe Via Flyer
 - 1 Aloe Vera Box
 - 1 Starbox

+ PRODUKTE SIPAS ZGJEDHJES SUAJ ME VLERË 11,600 Lekë

Në porosinë e parë që do të bëni në muajin e parë pas regjistrimit do të përdorni kuponin dhuratë **2,500 Lekë**. Për të përdorur kuponin duhet të bëni një porosi me vlerë minimale **7,450 Lekë** dhe duhet të specifikoni që dëshironi të përdorni kuponin dhuratë në momentin e kryerjes së porosisë.

2,500 Lekë
KUPON LR

DHURATË



Hapi 2: Plotësoni porosinë tuaj si më poshtë:

Nëse keni zgjedhur Starter Setin Business mund të përzgjidhni një nga ofertat e mëposhtme.

Në porosinë e regjistrimit ju mund të zgjidhni Setin Aloe Via ose Zeitgard, ose të 2 bashkë me çmim preferencial me ulje deri në 25%:

Aloe Via Kodi 95454-34

Çmimi total i produkteve Aloe Via:

~~19,010 Lekë~~ **në 14,690 Lekë**



-23%

PW 170 / GV 10,500

Starter Pack Aloe Vera përmban:

Set Aloe Via Moments: Krem Delikat për Duart, Xhel për Dush Vitalizues, Krem Delikat për Trupin, Balsam Hidratues për Trupin, Deo Roll-on Mbrojtës, Shami të Lagura për Pastrim, Pastë në formë, Xheli për Dhëmbët Ekstra i Freskët, Krem Trajtues për Këmbët.



Zeitgard Kodi 95455-34

Çmimi total i produkteve Starter Pack Zeitgard:

~~22,970 Lekë~~ **në 17,190 Lekë**



-25%

PW 200 / GV 12,000

Starter Pack Zeitgard përmban:

Cleansing System-Set Classic për lëkurë normale (produkt pastrimi + furçë Classic), Produkt pastrimi, Soft për lëkurë të ndjeshme, Furçë pastrimi – Soft, për lëkurë të ndjeshme



Adresa:
LR Health & Beauty
Rr. e Elbasanit, Nr. 246, H. 1
Njësia Bashkiake Nr.2, Kodi
Postar 1003 Tiranë/Albania

Kontakt:
Mob.: +355 69 60 99 998
Tel.: +355 4 2467 907
Fax: +355 4 2467 834
E-Mail: order.al1@lrworld.com
Web: www.lrworld.com

**UPGRADE
YOUR LIFE**

Tani ju keni mundësinë të REGJISTROHENI si partner duke përdorur një nga AUTOSHIPET e mëposhtme të përzgjedhur nga ju.

Autoship: Produkti juaj i preferuar me ulje speciale deri në 26% për 4 muaj.



ALOE VERA DRINKING GELS || Ulje deri në 26%

3x  INTENSE SIVERA Kodi 2980667	3x  ACTIVE FREEDOM Kodi 2980668	3x  IMMUNE PLUS Kodi 2981000	DHURATË  në muajin e 4-t.	3x  PJESHKË Kodi 2980666	3x  MJALTË Kodi 2980665	DHURATË  në muajin e 4-t.	
Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.			PW 110 GV 5359,01 7,490 Lekë/muaj	Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.			PW 100 GV 4979,75 6,990 Lekë/muaj

5IN1 BEAUTY ELIXIR & MIND MASTER || Ulje deri në 26%

 5IN1 BEAUTY ELIXIR Kodi 2981030	DHURATË  në muajin e 4-t.	5x  MIND MASTER FORMULA GREEN Kodi 95587	5x  MIND MASTER FORMULA RED Kodi 95587	DHURATË  në muajin e 4-t.	
Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.		PW 125 GV 7061,01 9,490 Lekë/muaj	Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.		PW 70 GV 3751,21 5,290 Lekë/muaj

TURBOKIDS || Ulje deri në 25%

LR HEALTH KIDS 1 Kodi 95582 Aloe Vera Drinking Gel me Mjaltë VitaActive Fruta të Kuqe Colostrum Liquid	DHURATË  në muajin e 4-t.	LR HEALTH KIDS 2 Kodi 95583 Aloe Vera Drinking Gel me Mjaltë VitaActive Fruta të Kuqe Pro 12 Kapsula	DHURATË  në muajin e 4-t.		
Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.		PW 85 GV 4810,67 6,750 Lekë/muaj	Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.		PW 85 GV 4712,92 6,650 Lekë/muaj

NIGHT MASTER || Ulje deri në 25%

Night Master Kodi 2980937 5X Mind Master Formula Green 1x Night Master	DHURATË  në muajin e 4-t.	Night Master Kodi 2980936 5X Mind Master Formula Red 1x Night Master	DHURATË  në muajin e 4-t.		
Zgjidhni një prej kodeve dhe abonohuni për 4 muaj.		PW 125 GV 776,38 10,890 Lekë/muaj			

PËR POROSI

Orari : E Hënë - E Premte
 Ora 09:00-18:00
 Mob.: (+355) 69 60 99 998
 Tel.: (+355) 042467907 (shtypni nr 2)
 Email: order.al1@lrworld.com
 Web:shop.lrworld.com

INFORMACIONE & PROBLEMATIKA

Për informacione dhe problematika rreth aktivitetit tuaj me LR-në kontaktoni:
T: (+355) 042467907 (shtypni nr 2)
E: service.al@lrworld.com
M: (+355) 69 60 99 998

NA VIZITONI NË FAQET:

www.lrworld.com
 www.lrgf.com
 Instagram: lr_albania_official
 FB: LR Health & Beauty Albania

TRANSPORTI

Dërgimi i porosisë bëhet brenda 48 orësh (ditë pune) nga data e faturimit. Pagesa bëhet me lekë në dorë në momentin e dorëzimit të pakos tuaj. Shpenzimet e transportit përfshihen në vlerën totale të faturës.

VLERA E POROSISË (me TVSH)	0 - 6,820 Lekë	6,820 - 14,999 Lekë	≥15,000 Lekë e sipër
SHPENZIMET E TRANSPORTIT (pa TVSH)	186 Lekë	124 Lekë	0 Lekë

FAST TRACK BONUS

NGJISNI SHKALLËT E KARRIERËS ME SHPEJTËSI!

Niveli 1 (Junior Manager)

DO
THIS

4.000 PW Totale, të paktën 100 PW Personale, **2 x Linja me 500 PW**, 2.000 PW Mbetje nga linja me 4.000 PW ose më lart.

250 €

GET
THAT

për muaj e garantuar* plus **bonus makine**, plus fitim mbi shitjet (shitjet tek klientët).

Niveli 2 (Manager)

DO
THIS

8.000 PW Totale, të paktën 100 PW Personale, **2 x Linja me 500 PW**, 4.000 PW Mbetje nga linja me 4.000 PW ose më lart.

500 €

GET
THAT

për muaj e garantuar* plus **bonus makine**, plus fitim mbi shitjet (shitjet tek klientët).

Niveli 3 (Junior Team Leader)

DO
THIS

12.000 PW Totale, të paktën 100 PW Personale, **3 x Linja me 500 PW**, 4.000 PW Mbetje nga linja me 4.000 PW ose më lart.

1000€

GET
THAT

për muaj e garantuar* plus **bonus makine**, plus fitim mbi shitjet (shitjet tek klientët).

KODI I ETIKËS SË BASHKËPUNËTORËVE TË “LR HEALTH & BEAUTY” SHPK

Kodi i Etikës rregullon sjelljen dhe marrëdhënien e bashkëpunëtorëve të LR-së me konsumatorët përfundimtarë, me kompanitë konkurrenente MLM, me bashkëpunëtorët e tjerë të LR-së dhe ofron udhëzime për ndërveprimin e drejtë dhe të barabartë midis tyre. Kodi i Etikës mbështetet qartë në sistemin e Vlerave të LR-së. Synon të mbrojë dhe të kënaqë bashkëpunëtorët dhe konsumatorët përfundimtarë, të cilët promovojnë konkurrencën e qëndrueshme të modelit të biznesit, vazhdojnë traditën dhe ruajnë reputacionin e kompanisë.

1. Sjellja ndaj konsumatorëve përfundimtarë. Bashkëpunëtorët e LR-së ofrojnë shërbimin më të mirë ndaj konsumatorëve përfundimtarë. Në këtë kontekst:

- 1.1. Bashkëpunëtorët e LR-së aplikojnë vetëm metoda të qarta dhe të drejta të shitjes.
- 1.2. Bashkëpunëtorët duhet t'u japin konsumatorëve informacione të qarta dhe të plota në lidhje me produktet, informacione të detajuara për çmimet, për kushtet e pagesës, të kthimit dhe të drejtën e tërheqjes. Përcillen vetëm informacione të cilat përputhen me deklaratat zyrtare të kompanisë.
- 1.3. Bashkëpunëtorët e LR-së respektojnë jetën personale të konsumatorëve përfundimtarë. Prezantimi i produkteve bëhet vetëm kur konsumatori përfundimtar bie dakord. Mbrojtja e informacioneve personale të konsumatorit përfundimtar është gjithmonë prioritet.
- 1.4. Bashkëpunëtorët e LR-së karakterizohen për ndershmërinë e tyre. Nuk shfrytëzojnë mungesën e përvojës, sëmundjet, moshën ose shkathësinë e pamjaftueshme të konsumatorëve përfundimtarë.
- 1.5. Porositë e konsumatorëve përfundimtarë duhet të përpunohen në një kohë të shkurtër. Dorëzimi duhet të bëhet brenda 14 ditëve, vetëm në rast se është caktuar një ditë tjetër dorëzimi. Nëse do të ketë probleme gjatë kryerjes së porosisë, ato duhet të bëhen të njohura menjëherë te marrësi përfundimtar i porosisë.

2. Sjellja gjatë krijimit të bashkëpunëtorëve të rinj. Sinqeriteti dhe mirëkuptimi janë është çelësi për një me s te vogel Sponsorizim të suksesshëm.

2.1. Gjatë sponsorizimit paraqiten mundësitë për karrierë dhe për të ardhura. Gjithashtu duhet të përmenden informacione për kostot dhe shpenzimet, të cilat i ngarkohen konsumatorit përfundimtar.

2.2. Shembuj të të ardhurave të bashkëpunëtorëve duhet të përputhen me realitetin. Nuk lejohet të jepet garanci për të ardhura fikse.

2.3. Informacione për produktet lejohen të jepen vetëm në qoftë se përputhen me deklaratat zyrtare të kompanisë.

2.4. Duhet të shmangen deklaratat negative ose ofenduese për kompani të tjera MLM dhe për produktet e tyre.

3. Sjellja midis Bashkëpunëtorëve të LR-së. Midis rrjeteve mbizotëron një konkurrencë e shëndetshme dhe e drejtë, e cila karakterizohet nga respekti reciprok.

Ndalohet rreptësisht “vjedhja” e bashkëpunëtorëve të rrjeteve të tjera në kompani. Në këtë kontekst theksohet se ndalohet:

- Inkurajimi i bashkëpunëtorëve për largim nga rrjeti nëpërmjet premtimeve si: shërbimi më i mirë, mundësi më të mira për karrierë, etj.
- Inkurajimi i bashkëpunëtorëve në shkeljen e kontratës, si psh nëpërmjet opsionit “straw men” (kur ndodhin keqkuptime të paramenduara nga njëra pale që të ketë përfitime të njëanëshme).
- Deklarata negative ose përcmuese për bashkëpunëtorët të tjerë të LR-së.
- Mosmarrëveshjet nuk duhet të paraqiten publikisht në media (psh. në gazeta, në rrjetet sociale dhe në burime të tjera publike të informacionit).

4. Sjellja e bashkëpunëtorëve të LR-së me kompani të tjera MLM. Respektojmë çdo kompani tjetër MLM.

4.1. Strategjia e padëshiruar dhe e padrejtë për vjedhjen e bashkëpunëtorëve nga kompani të tjera MLM nuk është e pranueshme nga LR-ja. Në këtë kontekst theksohet se ndalohet:

- Vjedhja e rrjeteve me shumë bashkëpunëtorë nga kompanitë konkurruese nëpërmjet komunikimit sistematik.
- Deklarata negative ose përcmuese për këto kompani (të ardhurat, produktet, etj).
- Inkurajimi i bashkëpunëtorëve për shkeljen e kontratës.
- Premtime për shpërblime financiare në rast të ndryshimit të kompanisë.

4.2. Nuk lejohen deklaratat e padrejta dhe fyese për bashkëpunëtorët e kompanive të tjera MLM.

5. Sjellja e Bashkëpunëtorëve të LR-së kundrejt kompanisë.

Bashkëpunëtorët e LR-së duhet të kenë një sjellje të ndershme me kompaninë LR.

5.1. Sjellja e bashkëpunëtorit të LR-së duhet të karakterizohet nga ndershmëria dhe drejtësia në të gjitha aktivitetet e biznesit.

Çdo manipulim i Planit të Marketingut është i patolerueshëm, pasi dëmton modelin e biznesit të LR-së. Në këtë kontekst përmendim shembujt në vijim, si shembuj përfaqësues të një sjelljeje të tillë: shitja e produkteve në tregje të mëdha, kthimi i padrejtë i tyre, prishja e konkurrencës nëpërmjet çmimeve më të ulta se çmimi i tregut nëpërmjet faqeve të internetit, ankandeve, manipulimi i kërkesave të bashkëpunimit etj.

5.2. Bashkëpunëtorët e LR-së sille me ndershmëri kundrejt kompanisë dhe e përfaqëson kudo me përgjegjësi. Si një përfaqësues i saj përpiqet me aq sa i jepet mundësia të parandalojë dëmtimin e kompanisë.

5.3. Tërësia e sjelljeve të mësipërme të bashkëpunëtorëve të LR-së përbën Termat dhe Kushtet e LR Health & Beauty.

6. Prezenca publike e Bashkëpunëtorëve të LR-së. Bashkëpunëtorët e LR-së duhet të paraqiten gjithmonë si biznesmenë seriozë.

6.1. Bashkëpunëtorët e LR-së nuk janë punonjës të LR-së, por as kontraktorë të LR-së. Ata nuk duhet të japin përshtypjen se punojnë si punonjës të saj.

6.2. Komunikimi me gazetën, televizionin, radion dhe mediat sociale është përgjegjësi vetëm e kompanisë LR. Kërkesat nga mediat duhen të marrin patjetër aprovim në sektorin përgjegjës të LR-së.

Të gjitha deklaratat në lidhje me kompaninë, me bashkëpunëtorët të tjerë ose me kompani të tjera në mediat (plus Facebook dhe Twitter) duhet të respektojnë rregullat e komunikimit si më sipër. Për çdo paqartësi duhet të kontaktohet më përpara me kompaninë LR.

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për të gjithë bashkëpunëtorët e LR-së. Të gjithë bashkëpunëtorët kanë për detyrë ta zbatojnë rreptësisht!

KUSHTET E BASHKËPUNIMIT ME “LR HEALTH & BEAUTY” SHPK

• E drejta për të blerë nga LR fillon nga dita në të cilën Kontrata e Bashkëpunimit është pranuar nga LR, jepet kodi i Bashkëpunëtorit dhe bashkëpunëtori merr Starter Set-in.

• Në qoftë se bashkëpunëtori dëshiron të ushtrojë aktivitetin e tij të lirë, ka për detyrë të zbatojë dispozitat e legjislacionit tatimor Shqiptar. Nëse Bashkëpunëtori është tregtar dhe blen produktet e kompanisë për rishitje, duhet të dorëzojë NIPT-in e tij dhe të kërkojë lëshimin e Faturës së Shitjes.

• Produktet blihen vetëm dhe direkt tek LR. Partneri shet produktet LR ekskluzivisht me shitje të drejtpërdrejt, për llogari të vet, dmth përjashtohet tregtia në vende të qëndrueshme, në tregje, ekspozita apo ankande.

• Bashkëpunëtorit të LR-së i lejohej të bëjë vetëm deklarata që kanë lidhje me LR, me produktet e LR-së dhe mënyrën e promovimit, të cilat përputhen me kushtet zyrtare të LR-së. Bashkëpunëtori është i detyruar të mos bëjë reklamime të produkteve dhe shërbimeve të kompanive të tjera tek Bashkëpunëtorët e tjerë të LR-së dhe as të mos ndërmjetësojë në shitjen e tyre.

• Për reklamimin e produkteve, është i detyruar të përdorë si mjete ndihmëse për shitjet (broshura, lista e çmimeve, katalogje, etj) që janë të LR-së dhe vetëm origjinale. Përdorimi i broshurave të shitjeve jo të aprovuara i jep të drejtën kompanisë për ndërprerjen e bashkëpunimit.

• Partneri është i detyruar që gjatë aktivitetit të tij, të respektojë Policën e Internetit për publikimet e tij në çdo faqe interneti. Polica e Internetit mund ta gjendet në webin: <https://www.my-lrworld.com/al/mylr-albania/sherbimi-ndaj-klientit/legal/>.

• Me nënshkrimin e Kontratës së Bashkëpunimit, Partneri i jep të drejtën LR –së të përdorë të dhënat e regjistrimit që jepen në formular, në doli të marrëdhënies kontraktuale.

• Është e ndaluar që tek të dhënat e bashkëpunëtorit të vendosen të dhëna të tjera, që mund ti përkasin dikujt tjetër. Të dhënat si: adresa e banimit, numri I telefonit, adresa e emailit, llogaria bankare duhet të jenë reale e vetë Bashkëpunëtorit.

• Është e ndaluar që Bashkëpunëtori i LR-së të japë informacione tek palët e treta dhe të dhëna rreth Bashkëpunëtorit të LR-së pa lejen e LR-së dhe Bashkëpunëtorit që bëhet fjalë.

• Sistemi i njohur i dhënies së Bonusit të LR-së është i rregulluar sipas Planit të Marketingut LR.

• Në qoftë se Bashkëpunëtori sponsorizon bashkëpunëtorë të tjerë, merr një shpërblim për informimin dhe mbështetjen e tyre sipas LR Marketing Plan.

• Bashkëpunëtori merr bonus kur ka të paktën 100 PW xhiro personale dhe 250 PW totale në mbyllje të çdo muaji.

• LR ka të drejtë të zbrësë nga bonusi i Bashkëpunëtorëve borxhet që mund të kenë ata ndaj kompanisë. Bashkëpunëtorit nuk i lejohej të zbrësë nga Bonuset dhe përfitimet borxhet e tij.

• Pajtueshmëria me linjat e para të sponsorit përbën një parim themelor të sistemit të LR-së, e domosdoshme për mbrojtjen e të gjithë Bashkëpunëtorëve. Sipas kësaj, është e pamundur për të transferuar një Bashkëpunëtor në një tjetër linjë. Ish-Bashkëpunëtorë dhe

të paktën të afërmit të shkallës së parë kanë mundësi që pas 12 muajve të bashkëpunimit të tyre me LR-në të riaktivizohen në linjën që duan, me përjashtim të rastit nëse riaktivizohen më herët nga i njëjti sponsor.

• Në rast të shkeljes së kushteve, LR-ja ka të drejtë të ndërpresë bashkëpunimin pa detyrime të mëtejshme. Nëse një Bashkëpunëtor dëshiron të ndërpresë bashkëpunimin, ka për detyrë ta bëjë të njohur me shkrim në fund të muajit. Bashkëpunimi ndërpritet nëse brenda 12 muajve nga data e fundit e lëshimit të faturës së fundit, Bashkëpunëtori s'ka bërë asnjë porosi.

Rregullat bazë për bashkëpunëtorët LR

1. Ka të drejtë për tu bërë bashkëpunëtor i LR-së :

• Çdo person fizik sipas Kodit Civil Shqiptar.

• Çdo person juridik sipas Kodit Civil Shqiptar.

• Një skuadër (Team) prej 2 personash nën një kod bashkëpunimi.

• Është e ndaluar që një bashkëpunëtor i cili ka një kod aktiv në kompani të hapë një kod tjetër bashkëpunëtorit për çdo lloj arsye, qoftë edhe në shtete të ndryshme.

• LR rezervon të drejtën për të pranuar ose refuzuar kërkesën për bashkëpunim!

2. Team

• Përkufizimi: Dy persona të regjistruar nën të njëjtin kod bashkëpunëtorë quhen Team. Të dy anëtarët e Team-it duhet të nënshkruajnë një Kontratë Bashkëpunimi.

• Pranimi i Team-it: bashkëpunëtori i ri i Team-it , bëhet një bashkëpunëtor i LR-së nëse plotëson Kontratën e Bashkëpunimit, dhe nënshkruhet nga të dy partnerët.

• Dalja e një partneri nga Team kërkon konfirmimin e Partnerit, e Sponsorit dhe Orgaleader.

• Team nëpërmjet bashkimit: bashkëpunëtori i ri i Team-it është tashmë bashkëpunëtor i LR-së pasi ai bën aplikimin përmes Formularit të Kontratës së Bashkëpunimit.

• Bashkimi nuk duhet të jetë në disavantazh të bashkëpunëtorit tjetër.

• Nuk miratohet në rastin e dy bashkëpunëtorëve në nivelin 21% dhe TL /OL.

• Nuk miratohet në raste aplikimi nga struktura të ndryshme.

• Bashkimi lejohej në rast se aplikanti është sponsor i bashkëpunëtorit tjetër (por jo në rastin e dy bashkëpunëtorëve në nivelin 21% ose TL /OL).

• LR ka fjalën e fundit për pranimin ose refuzimin e Kontratës së Bashkëpunimit.

3 .Bashkëshorti, i cili regjistrohet për herë të parë në LR, ka 2 mundësi për të filluar si bashkëpunëtor i LR-së:

-Hyryr si Team (kod dhe bashkëpunim i përbashkët)

-Si nivel i parë i bashkëshortit (bashkëpunim i pavarur, kod më vete bashkëpunëtor)

4. Struktura ose mbrojtja e nivelit

• Përkufizimi: Mbrojtje e strukturës do të thotë që të ruhet çdo marrëdhënie sponsor-

bashkëpunëtor. Në këtë mënyrë çdo bashkëpunëtor do të ketë vetëm një sponsor.

• Ndryshimi i strukturës: Një bashkëpunëtor aktiv mund të kalojë në një strukturë tjetër vetëm pas 12 muajve të të qenit inaktiv.

• Aktiviteti: Veprimtaria e një bashkëpunëtor i referohet natyrës së biznesit të ndërmarrë me LR-në, drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte.

• Inaktiviteti: Inaktivitet do të thotë të mos kesh aktivitet direkt apo indirekt me LR-në gjatë një periudhe prej 12 muajsh.

• Fillimi i mbrojtjes së nivelit/strukturës: Mbrojtja e nivelit fillon sapo LR pranon aplikimin efektiv të bashkëpunimit. Në rast konflikti mbi një krijim në internet, mbrojtja e nivelit do të fillojë vetëm kur sponsori siguron aplikimin e bashkëpunëtorit, të nënshkruar nga bashkëpunëtori i ri, pa vonesë (dmth brenda 3 ditëve). Në rast të një konflikti të vjetër, LR do të vendosë sipas zgjedhjes së saj se cila i duket e arsyeshme.

• Mbrojtja e nivelit/strukturës kundrejt fillimit të kontratës: Mbrojtja fillon me pranimin e aplikimit efektiv të kërkesës dhe përfundon pas 12 muajsh pasiviteti! Marrëdhënia kontraktuale fillon me dorëzimin e porosisë së parë. Refuzimi i porosisë së parë të Starter Set-it sjell përfundimin e marrëdhënies së biznesit por jo mbrojtjen e nivelit/strukturës.

5.Ndryshimi i nivelit.

• Në përgjithësi riorganizimet nuk lejohej! Përjashtime bëjnë rastet kur:

• Krijim i gabuar nga LR, menjëherë pas zbulimit.

• Krijim i gabuar nga sponsori menjëherë pas zbulimit.

• Gjithmonë për riorganizimet do të kërkohej miratimi i LR-së. Është i ndaluar bashkimi i strukturave.

6. Rikthimi i ish-bashkëpunëtorëve: Një ish-bashkëpunëtor mund të rikthehet në biznes. Pas 12 muajsh pasivitet (shikoni 4) bashkëpunëtori është plotësisht i lirë të zgjedhë organizatën e tij, pa marrë parasysh anëtarësimin e tij të mëparshëm në organizatë.

7. Porosi në fund të muajit kalendarik. Fundi i muajit shënon edhe fundin e periudhës së bonusit mujor!

• Porositë e mbërritura pas mesnatës në ditën e fundit të muajit nuk do të jenë të vlefshme për datën e muajit të kaluar.

• Nuk është e mundur të transferohen pagesat nga muaji aktual në muajin e ardhshëm.

• Kthimet (paketat e shpërndara kthehen përsëri për shkak të refuzimit, mbarimit të periudhës së mbajtjes në postë, pranues i panjohur) regjistrohen në muajin e kthimit të paketës LR. Bonusi i llogarit fillimisht për muajin e kaluar, në përgjithësi nuk mund të ndryshohet në mënyrë retrospektive- muaji aktual do të kreditohet me vlerë negative sipas PV/GV.

8. Produktet:

• LR garanton cilësinë e lartë të produkteve.

• LR rezervon të drejtën e vonesave në rastet e forcave madhore.

• Kthimi i produkteve mund të bëhet brenda 14 ditëve nga data e faturimit, i shoqëruar me faturën e blerjes.

Me anë të kësaj deklarate “**LR Health & Beauty**” SH.P.K., dëshirojmë t’ju informojmë për mënyrën sesi e mbledhim informacionin tuaj personal, e procesojmë dhe e përdorim atë për marrëdhënien tonë të biznesit.

LR Health & Beauty SH.P.K. i përmbahet kërkesave të Rregullores së BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (EU-General Data Protection Regulation (GDPR) dhe ligjeve të tjera për mbrojtjen e të dhënave.

1. Çfarë të dhëna personale mbledhim nga ju?

Të dhënat personale janë të gjitha informacionet në lidhje me një person fizik specifik ose të identifikueshëm që ju deklaroni, që krijohet apo mblihet nga ne. Ne procesojmë dhe përdorim të dhënat tuaja si në vijim: **Të dhënat personale:** emri, adresa, data e lindjes, numri i telefonit, faksit dhe celularit, adresa e emailit, si dhe detajet e llogarisë suaj dhe çdo informacion që ju e jepni vullnetarisht (p.sh. informacionin e kartës së kreditit) dhe informacionet e kërkuara ligjërish. **Të dhënat e porosisë** dhe shitjes: Të dhënat e porosisë që ju keni bërë dhe të ardhurat e krijuara. **Të dhënat strukturore:** Të dhënat për strukturën tuaj sipër linjës tuaj dhe poshtë linjës tuaj, partnerët që ju kanë sponsorizuar direkt ose indirekt (linja sipër jush) dhe partnerët që ju keni sponsorizuar direkt dhe indirekt (linjat poshtë jush)

2. Për çfarë dhe në çfarë baze ligjore ne përdorim të dhënat tuajat personale?

2.1 Të Dhënat Personale. Ne përpunojmë të dhënat tuaja kryesore në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 të ligjit GDPR, për zbatimin e Kontratës së Bashkëpunimit të lidhur me ju. Kjo përfshin përdorimin e të dhënave tuaja për dërgimin e mesazheve elektronike, në kuadër të kujdesit ndaj partnerit. Kjo vlen edhe për procedimet për zbatimin e masave para-kontraktuale. Të dhënat do të jenë gjithashtu në dispozicion të partnerëve të tjerë, deri në atë masë sa kërkon kujdesi i tyre kontraktual. Pa mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tuaja kryesore, nuk është e mundur as mbyllja dhe ekzekutimi i kontratës. Për më tepër, ne përpunojmë të dhënat tuaja kryesore për qëllime marketingu, për aq sa kjo është një interes legjitim (neni 6 (1) (f) GDPR) ose për sa kohë janë të miratuara në këtë drejtim (neni 6 (1) (a) GDPR). Në veçanti, ne ju dërgojmë rregullisht email-e informuese marketingu, ku ju jeni regjistruar për t’u informuar rreth të rejave, ndryshimeve dhe ofertave. Baza ligjore për këtë miratim nga ana juaj është në përputhje me nenin 6 Paragrafi 1 të ligjit të GDPR.

2.2 Të dhëna nga porosi dhe shitje. Ne procesojmë të dhënat që vijnë nga porositë tuaja për ekzekutimin dhe zgjidhjen e porosisë të miratuara. Të dhënat e porosisë dhe shitjeve do të përpunohen gjithashtu për të llogaritur bonusin tuaj sipas kontratës shoqëruese, veçanërisht sipas planit të marketingut, që ju keni të drejtë dhe partnerët që janë sipër jush që ju kanë promovuar ju si partner. Të dhënat gjithashtu do të vihen në dispozicion të partnerëve të tjerë, sa i përket

këtij bonusi. Baza ligjore në këto raste është Neni 6 (1) (b) GDPR. Pa këtë përpunim të dhënash mbi porositë dhe shitjet, nuk është e mundur të lidhet dhe të përmbushet një kontratë (në lidhje me porosinë dhe kontratën e partnerëve).

2.3 Të dhënat strukturore. Të dhënat strukturore përpunohen për të llogaritur bonusin, në të cilin ju dhe partnerët sipër linjës tuaj, prej të cilëve ju jeni rekrutuar direkt ose indirekt si partner, keni të drejtë sipas planit të marketingut. Të dhënat gjithashtu do të vihen në dispozicion të partnerëve të tjerë, sa i përket shpërblymit. Baza ligjore në këto raste është Neni 6 (1)(b) GDPR. Rastësisht, ne përpunojmë të dhënat tuaja strukturore për analizat e tregut, statistikave, për të shmangur keqpërdorimin dhe për të optimizuar kujdesin përdorisë ekziston një interes legjitim legjislativ (Neni 6 (1) (f) GDPR). Pa përpunimin e të dhënave tuaja strukturore, lidhja dhe zbatimi i Kontratës së Bashkëpunimit nuk është i mundur.

2.4 Asnjë vendimarrje e automatizuar. Ne nuk marrim vendime që kanë ndonjë efekt ligjor mbi ju ose që ndikojnë në një mënyrë të ngjashme dhe që bazohen vetëm në përpunimin automatik të të dhënave tuaja.

3. E drejta për të kundërshtuar. Ju mund të kundërshtoni përpunimin e të dhënave për qëllime të marketingut, në çdo kohë. Kjo vlen veçanërisht për përdorimin e të dhënave tuaja për dërgimin e informacioneve marketing. Ne më pas jemi të detyruar ligjërish të ndalojmë mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave. Nëse i përpunojmë të dhënat tuaja personale në bazë të një interesi të ligjshëm sipas nenit 6, paragrafi 1 GDPR, ju mund të kundërshtoni këtë përpunim në çdo kohë për arsye tuaja. Në këtë rast, ju lutemi kontaktoni zyrën e treguar në pikën 6. Kompania më pas do të kontrollojë nëse interesi i saj legjitim në përpunimin e të dhënave është më i madh në rastin tuaj ose nëse interesat tuaja mbizotërojnë për shkak të situatës tuaj të veçantë. Në rastin e fundit, ne do të ndalojmë përpunimin e të dhënave tuaja në përputhje me kundërshtimin tuaj. Në këtë rast, ne nuk do të jemi në gjendje të përpunojmë urdhrat ekzistues dhe ndoshta të ardhshëm.

4. Kalimi tek palët e treta. Ne nuk i ndajmë informacionet tuaja personale me palët e treta për qëllime marketingu. Transferimi i të dhënave personale tek palët e treta bëhet vetëm nëse dhe për aq kohë sa: (i) kjo është e nevojshme për zgjidhjen e marrëdhënive kontraktuale (në veçanti për transferimin e partnerëve të rrjetit tuaj në linjat poshtë ose sipër), (ii) kërkohet nga ligji për ta bërë këtë, ose (iii) për të zbatuar marrëdhëniet kontraktuale ose marrëveshjet e tjera të bëra me ju. Nëse një partner i rrjetit tuaj ndodhet në një vend të tretë jashtë Zonës Ekonomike Evropiane, të dhënat transmetohen vetëm nëse kushtet janë sipas GDPR dhe nëse marrësi është person i përshtatshëm dhe është siguruar niveli i mbrojtjes së të dhënave.

5. Siguria. Ne marrim masa teknike dhe organizative për të siguruar që të dhënat tuaja personale të mbrohen nga humbja, nga modifikime të pasakta ose qasje të paautorizuara nga palët e treta. Masat janë përshtatur vazhdimisht me përmirësimin e mundësive teknike.

6. Informacion për kontakte. Organi përgjegjës: LR Health & Beauty shpk, Rr. E Elbasanit, Nr. 246, H. 1, Tiranë, Albania. service.al@lrworld.com
Theksojmë se ju jeni përgjegjës për përpunimin e të dhënave tuaja personale, të cilat i keni ndarë në mënyrë direkte apo indirekte me partnerë të tjerë. Për të siguruar të drejtat e mbrojtjes së të dhënave tuaja, ju lutemi na kontaktoni.

7. Ruajtja e të dhënave. Ne ruajmë të dhënat tuaja personale për aq kohë sa qëllimi i ruajtjes së të dhënave është i vlefshëm. Të dhënat tuaja personale, porositë, shitjet, si dhe të dhënat strukturore ruhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës me ju. Pas përfundimit të kontratës, ne ruajmë të dhënat tuaja personale, porositë, shitjet dhe të dhënat strukturore nëse kjo kërkohet nga rregulloret e BE-së dhe ato kombëtare, nga ligjet, ose është e nevojshme për të mbrojtur interesat tona legjitime. Vetëm të dhënat e ruajtura për qëllime të marketingut do të fshihen nëse ju e kërkon.

8. Të drejtat tuaja. Sipas GDPR-së, ju keni të drejtë të kërkonte informacion, korrigjime, fshirje dhe kufizime, të kërkonte të drejtën tuaj për transferimin e të dhënave dhe të drejtën tuaj për të kundërshtuar siç përshkruhet më lart dhe të revokoni pëlqimin tuaj. Nëse GDPR i bashkon këto të drejta tek kushtet, kjo zbatohet vetëm nëse ato përmbushen. Ju lutemi përdorni kontaktet e mësipërme për të kërkuar të drejtat tuaja. Vendosja e identitetit tuaj duhet të provohet për të shmangur informacionin drejt palëve të treta të paautorizuara. Ju gjithashtu keni të drejtë të parashtroni një ankesë pranë autoritetit kompetent mbikëqyrës. Nëse keni ndonjë dyshim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave tuaja, ju lutem na njoftoni në mënyrë që ta sqarojmë.

9. Ndryshime tek Deklarata e privatësisë
Herë pas here mund të jetë e nevojshme të përshtatet përmbajtja e kësaj Deklarate Privatësie. Ne rezervojmë të drejtën për t’i ndryshuar ato në çdo kohë. Ne gjithashtu do të publikojmë versionin e ndryshuar të Deklaratës së privatësisë këtu. Nëse na vizitoni në faqen tonë të internetit, duhet të lexoni përsëri Deklaratën e Privatësisë.